



Republika e Kosovës Nr./Br. 822 / 2025
Republika Kosova – Republic of Kosovo **PRISHTINË - PRIŠTINA**
Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7, paragrafi 1, nënparagrafët 1.11 dhe 1.31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenin 8 të Udhëzimit administrativ me numër Nr.01/2023 për hartimin e akteve normative të KPK-së, më 30 prill 2025 miraton:

**RREGULLORE NR. 03/2025 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
RREGULLORES Nr.02/2021 PËR TRANSFERIMIN DHE AVANCIMIN E
PROKURORËVE TË SHETIT**

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores Nr.02/2021 për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit, me qëllim të harmonizimit të dispozitave ligjore që kanë ndryshuar lidhur me kriteret, përbërjen dhe procedurën për transferimin dhe avancimin e prokurorit të shtetit.

Neni 2

Neni 2 paragrafi 1.11 ndryshohet ashtu që fjala “transferim” zëvendësohet me fjalën “caktim”.

Neni 2 i shtohet paragrafi: 1.16

“Vlerësim pozitiv i performancës” – nënkupton nivelet e vlerësimit mjaftueshëm, mirë dhe i dalluar.

Neni 2 i shtohet paragrafi: 1.17

“Caktim i jashtëzakonshëm” – nënkupton kur një prokurori ka numër të pamjaftueshëm të prokurorëve apo /edhe me qëllim të rritjes së efikasitetit në prokurorinë përkatëse, si dhe kur kemi të bëjmë me trajtimin e rasteve të caktuara penale apo çështje të tjera sipas vlerësimit të kryeprokurorit.

Neni 3

Neni 4, paragrafi 1, pika 1.2 fshihet.

Neni 4

Neni 6, paragrafi 1, pika 1.2 të fshihet fjala “qortimi”.

Neni 5

Neni 7 Plotësohet/ndryshohet si në vijim:

Titulli: Fjala “transferim” të zëvendësohet me fjalën “caktim”, kurse pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Paragrafi 2: Fjala “transferim” zëvendësohet me fjalën “caktim”.

Shtohet paragrafi 3.

Caktimi i jashtëzakonshëm i prokurorit nuk mund të bëhet gjatë periudhës së trajnimit fillestar në Akademinë e Drejtësisë.

Neni 6

Neni 9, paragrafi 1, pika 1.3 e Rregullores bazike të transferimi i përhershëm i prokurorëve nga KPK-ja, **i shtohet teksti** “brenda prokurorive themelore, me përjashtim Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokuroria e Apelit dhe Prokuroria Speciale”.

Neni 7

Neni 10, paragrafi 1, pika 1.2 të fshihet fjala “qortimi”.

Neni 8

Neni 11, paragrafi 1, pika 1.5, ndryshohet si në vijim “nga Departamenti për Krime të Rënda dhe Departamenti për të Mitur i Prokurorisë Themelore”, pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

Neni 9

Neni 12, paragrafi 1, pika 1.2 të ndryshohet si në vijim: “të ketë vlerësim pozitiv të performancës”.

Neni 12, paragrafi 1, pika 1.3 të fshihet fjala “qortimi”.

Neni 10

Neni 13, paragrafi 1, pika 1.2 i rregullores bazike të kriteret e veçanta për avancim, **ndryshohet teksti**, i cilit tani e tutje do të jetë, si në vijim:

“për ta ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit, prokurori duhet të ketë së paku tri (3) vite përvojë si prokuror në Departamentin për Krime të Rënda apo Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore ose në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, si dhe vlerësim pozitiv të performancës” .

Neni 13, paragrafi 1 pika 1.4 i rregullores bazike të kriteret e veçanta për avancim, **i shtohet teksti** “prej tyre së paku tre (3) vite në Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale apo Departamentin për Krime të Rënda ose Departamentin për të Mitur të Prokurorisë themelore, si dhe vlerësim pozitiv të performancës” .

Neni 11

Neni 19 i rregullores bazike, të Komisioni për Transferim dhe Avancim të Prokurorëve, **ndryshohet teksti**, i cili tani e tutje do të jetë, si në vijim:

1. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, si në vijim:

1.1 Kryeprokurori i Shtetit, i cili do të jetë kryesues,

1.2 Anëtar i Këshillit nga radhët e Prokurorisë së Apelit,

1.3 Kryeprokurori i Prokurorisë përkatëse për të cilën shpallet konkursi.

2. Me rastin e shpalljes së konkursit për ZKPSH-në nga pika 1.3, një prokuror nga ZKPSH-ja i përzgjedhur nga Këshilli.

3. Komisioni do të ketë anëtarët rezervë sipas përbërjes në vijim:

3.1 Zëvendëskryeprokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit;

3.2 një anëtar i Këshillit, i zgjedhur me short;

3.3 Zëvendëskryeprokurori i prokurorisë përkatëse dhe

3.4 Në rast të përjashtimit të anëtarit nga paragrafi 2 i këtij neni, zëvendësohet me një prokuror tjetër nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Neni 12

Neni 22, paragrafi 1, riformulohet si në vijim: “KPK-ja vendos për kundërshtimin në takimin e parë të KPK-së, por jo më vonë se 30 ditë pune nga dita e pranimi të kundërshtimit”.

Neni 13

Dispozitat kalimtare

Të gjitha proceset e filluara para hyrjes në fuqi të këtij plotësim ndryshimi të Rregullores do të vazhdojnë sipas rregullave të përcaktuara në Rregulloren Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.

Neni 14
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Prishtinë, më 30 prill 2025

Ardian Hajdari

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

